



Pranuar / Dërguar Priljena / Predato Received / Delivery	09.03.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Org. / Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIMSHK	2528	2023	115



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.166/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, në çështjen juridike "kontestim konkursi" sipas ankesës me numër A.nr.166/2023 të datës 25.01.2023 të parashtruar nga ankuesja nga Ferizaj, duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1, Nenin 16 paragrafi 3 nën paragrafin 1.1 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/1-031 për Procedurën e Përgjithshme administrative, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 07.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. *Aprovohet si e bazuar* ankesa me numër A.nr.166/2023 e datës 25.01.2023 e parashtruar nga ankuesja
- II. *Anulohet* Vendimi me numër Nr. 01-199/22 i datës 20.12.2022 Njesisë së Burimeve Njerëzore lidhur me refuzimin e aplikacionit të ankueses, Vendimi me Nr.01-18/22 të datës 17.01.2023 të Kryesueses së Komisionit Vlerësuese për Lëvizje Brenda Kategorisë në Komunën e Ferizajt dhe Njoftimi për kandidatin e suksesshëm i datës 06.01.2023.
- III. *Obligohet* Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Ferizajt, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të rishqyrtoj aplikacionin e ankueses, duke marrë përsysh të gjeturat sipas këtij vendimi
- IV. *Obligohet* Kryetari i Komunës së Ferizajt, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrë të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi siç përcaktohet në pikën III të dispozitivit.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja e cila sipas shkresave të lëndës është kandidatë në procedurën e rekrutimit për pozitën e punës " Drejtor i Qendrës për Pune Sociale" Lëvizje Brenda Kategorisë, në Komunën e Ferizajt, me datën 20.12.2022 i është refuzuar aplikacioni me arsyetim se e njëjta nuk i plotëson kushtet e konkursit respektivisht të përvojës së punës të kërkuar sipas konkursit (se paku 5 vjet përvoje pune profesionale).

Tutje ankuesja ka parashtruar ankesë (pa datë dhe numër) tek organi i punësimit kundër vendimit numër Nr. 01-199/22 i datës 20.12.2022 lidhur me refuzimin e aplikacionit, ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Ferizajt përmes vendimit me NR.01-221/22 të datës 23.12.2022 ka refuzuar ankesën e ankueses si të pa bazuar.

Ankuesja e pa kënaqur me vendimin me numër 01-199/22 të datës 20.12.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore me datën 28.12.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 8509/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, ndërsa me datën 25.01.2023 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 827/2023 kundër vendimit me Nr.01-221/22 të datës 23.12.2022 lidhur me refuzimin e ankesës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 04.01.2023, ka proceduar kërkesën e ankueses për përgjigje në ankesë në Komunën e Ferizajt. Ndërsa Këshilli më datë 17.01.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Pas Vlerësimit të kërkesë se datës 07.02.2023 të Kolegjit të Këshillit Kryetari i Këshillit ka vlerësuar se ankuesja kundër procedurës se njëjtë të pranimit ka parashtruar dy ankesa me objekt te njëjte të cilat bazohen në gjendje faktike dhe bazë juridike të njëjtë, andaj ka marr vendimin me numër VK/2023 me te cilin ka bashkuar lëndët në një procedure të cilat kanë marr numrin e fundit të ankesës A.nr.166/2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit së kërkesa është e pranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 8509/2022 të datës 28.12.2022 të parashtruar nga ankuesja ne KPMSHCK; Vendimin me numër 01-199/22 të datës 20.12.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore; Konkursin e datës 23.11.2022 për pozitën e punës " Drejtor i Qendrës për Pune Sociale"; Provat shtese me numër të protokollit 201/2023 të datës 11.01.2023 të dërguar nga ankuesja përmes emailit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Aktin e Emërimit të datës 01.07.2011; Certifikatën e licencës me numër 673/20; Vërtetimin e datës 30.12.2022; Kërkesën për përgjigje ne ankesë me numër të protokollit 30/2023 të datës 04.01.2023; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 421/2023 të datës 17.01.2023; Listën e aplikativë me numër të referencës RN000010474; Shkresën e datës 20.12.2022 lidhur me emrin e kandidatës qe i plotëson kushtet; Njoftimin me numër 01-17/23 të datës 06.01.2023 për kandidatin e suksesshëm; Vendimin me numër 01.Nr.01-199/22 të datës 14.12.2022 për themelimin e komisionit te vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë; Ndryshim dhe plotësimi i akt emërimit të datës 11.06.2019; Ndryshim dhe plotësimi i akt emërimit të datës 10.09.2018; Ndryshim dhe plotësimin e akt emërimit të datës 01.02.2018; Akt emërimit të datës 01.07.2011; Ndryshimin dhe

plotësimin e aktit të emërimit të datës 25.11.2019; Aplikacionin e datës 16.12.2022; Pasqyrën e llogaris bankare (Trustin) për periudhën kohore 12.09.2003 deri me 09.02.2023; Vendimin me numër ref. 6/710; Diplomën me numër 15-106-04/2941 të datës 15.03.2011; Dokumentin e identifikimit të ankueses; Vërtetimin lidhur me dëshminë se ankuesja nuk ka pasur asnjë masë disiplinore të pashuar në dosjen e sajë; Akt emërimit të datës 01.07.2011 të ankueses; Vendimin me Nr.02-131/03-0114161/21 të datës 01.10.2021; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 23.02.2021; Aplikacionin e datës 15.12.2022 të kandidatës A.R; Aktin e emërimit të datës 23.01.2013; Diplomën universitare me numër 4162 të datës 04.09.2015; Pasqyrën e llogarisë bankare (Trustin), për periudhën kohore 01.08.2022 deri me datën 06.02.2023; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit të datës 11.06.2019; Vendimin me numër 01-67/21 të datës 15.12.2021 për emërimin e ushtruesit të detyrës së drejtorit të qendrës për punës sociale; Certifikatën nën shenjen ISSN 2286-4822; Certifikatën e datës 04.06.2022; Certifikatën e datës 19-20.03.2022; Vendimin Nr.219/2015 të datës 01.07.2015; Dokumentin e identifikimit; Certifikatën me Nr.11167/675 të datës 27.02.2012; Diplomën me Nr. 158 të datës 24.12.2020; Dokumentin e identifikimit të kandidatës së përzgjedhur; Vërtetimin nën shenjen LRP.NR.14141/2022 lidhur me notorizimin e Diplomës; Certifikatën e licencimit nën shenjen; 340/19R; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë të datës 26.11.2021; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë të datës 26.01.2021; Vërtetimin me të cilën dëshmohet se kandidatja A.R nuk ka ndonjë masë disiplinore të pa shuar në dosjen personale; Ndryshim dhe plotësimin e aktit të emërimit të datës 11.06.2019; Vendimin me numër .01-67/21 për emërimin e ushtruesit të detyrës së drejtorit të qendrës për punë sociale; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 29.01.2021; Vendimin me numër 01-221/22 të datës 23.12.2022; Ankesën me numër të protokollit 827/2023 të datës 25.01.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vërtetimin e datës 30.12.2022 të lëshuar nga Menaxherja e Personelit në Komunën e Ferizajt; Referencën nën shenjen QPS-594 të datës 21.04.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 1313/2022 të datës 03.0.2023; Emalin e datës 17.01.2023 të D.A drejtuar M.Z; Emalin e datës 15.02.2023 të D.A drejtuar Këshillit; Emalin e datës 08.02.2023 të F.V drejtuar Z.G lidhur me përgjigjen në ankesë; Vendimin me numër VK/2023 të datës 07.02.2023 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Emalin e datës 11.01.2023 të A.A drejtuar KPMSHCK-se lidhur me provat shtesë; Emalin e datës 15.02.2023 të ankueses drejtuar Këshillit.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankueses *është e bazuar, sepse:*

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë se Komuna e Ferizajt me datën 23.11.2022 ka publikuar në sistem qendror elektronik (SIMBNJ) Konkursin me numër reference RN000010474 për Lëvizje Brenda Kategorisë, për pozitën e punës "Drejtor i Qendrës për Punë Sociale, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja. Konkursi ka qenë i hapur për aplikim nga data 08.12.2022 deri me 16.12.2022, ndërsa përmes vendimit me numër 01-199/2022 të datës 20.12.2022, ankueses i është refuzuar aplikacioni me arsyetim se e njëjta nuk i plotëson kriterin e përvojës së punës të kërkuar sipas konkursit i cili ka përcaktuar se paku 5 vite përvojë pune profesionale.

Fillimisht Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka gjetur se kushte të veçanta për Lëvizje Brenda Kategorisë janë përcaktuar: *Të jetë nëpunës civil i të njëjtës kategori për të cilën aplikon; Te mos jete i ndëshkuar me ndonjë mase disiplinore që nuk është shuar ende; Të jetë vlerësuar të paktën mirë*

për rezultatet në punës, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit. Ndërsa kërkesat e përgjithshme formale kanë qenë; Diplomën e studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to në fushë të punës sociale, psikologjisë, sociologjisë, drejtësisë, pedagogjisë ose ne ndonjë lëmi tjetër të lidhur ngushtë me shërbimet sociale dhe familjare, si dhe kualifikim i posaçëm formal, Përvoja e punës së kërkuar së paku pese (5) vite përvoja punës profesionale, si dhe Licenca.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që vendimi për mos plotësimin e kushteve për aplikim me të cilin i është refuzuar aplikacioni, nuk është i drejte sepse jo vetëm që kam plotësuar kriteret e konkursit për rekrutimin po edhe i kame tejkaluar me faktin se e njëjta i kam ofruar dëshminë për përvojën e punës njëzet (20) vjeçare, si dhe kundër vendimit të datës 23.12.2022 me të cilin është refuzuar ankesa e ankues.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë të cilat rregullojnë procedurën e lëvizjes brenda kategorisë, gjegjësisht nenit 38 të këtij ligji me të cilin është përcaktuar se: "1. Plotësimi i pozitave të lira në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë. 2. Nëpunësit civilë të së njëjtës kategori në kuadër të Shërbimit Civil, që i plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e posaçme për vendin e lirë, mund të aplikojnë për plotësimin e një vendi të lirë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes, sipas paragrafit 1 të këtij neni, Në procedurën e lëvizjes brenda kategorisë për kategorinë profesionale mund të aplikojnë vetëm nëpunësit e kësaj kategorie, të konfirmuar sipas nënparagrafit 4.1 të nenit 37 të këtij ligji.

Po ashtu, Kolegji ka analizuar edhe dispozita e Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht: Nenin 44 me të cilin është përcaktuar se: "1.Konkurinimi për lëvizjen brenda kategorisë zhvillohet në dy faza: 1.1. verifikimi paraprak i kandidatëve; dhe 1.2. vlerësimi i kandidatëve. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ, ndërsa vlerësimi i kandidateve kryhet nga Komisioni i Vlerësimit për lëvizjen brenda kategorisë, krijuar sipas nenit 47 të kësaj Rregulloreje.

Kolegji i Këshillit pas analizimit të provave të dërguara nga pala si dhe provave të dërguara nga organi i punësimit ka gjetur se ankuesja sipas diplomës me Nr. 15-106-04/2941 të datës 15.03.2011, ka përfunduar Fakultetin Filozofik në programin Sociologji, po ashtu e njëjta posedon Nr. e Licencës 673/20 përmes të cilës dëshmohet se ankuesja është licencuar për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare dhe pranohet ne regjistrin e KPSHSK-së, si dhe sipas pasqyrës së llogarisë (Trustit), e njëjta dëshmon 20 vite e tetë muaj përvoja pune, ndërsa sipas akt emërimit të datës 01.07.2011 ankuesja është e punësuar në Komunën e Ferizajt në pozitën e punës, "Udhëheqëse e Sektorit te Rinisë".

Andaj Kolegji i Këshillit ka konstatuar se vendimi me Nr.01-199/22 të datës 20.12.2022 i Njësisë së Burimeve Njerëzore lidhur me refuzimin e aplikacionit të ankueses është në kundërshtim me nenin 45 paragrafi 1 te Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se 1.Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën konkurrohet. Rrjedhimisht sipas provave të administruara, Kolegji i Këshillit bazuar në të gjeturat dhe konstatimet si me lartë, konstaton së vendimi i kundërshtuar me ankesë është i përfshirë më

të meta të atilla që pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së tij, kështu që Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Ferizajt në ri procedurë duhet të rishqyrtoj aplikacionin e ankueses dhe të nxjerr vendim në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe në mbështetje të fakteve të vërtetuara në mënyrë të plotë dhe drejtë.

Po ashtu Kolegji i Këshillit, konstaton se edhe pse ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me aktin administrativ të verifikimit paraprak, në bazë të provave të lëndës, Komuna e Ferizajt ka vazhduar procedurën duke e përfunduar të njëjtën me aktin e njoftimit të kandidatit të suksesshëm të datës 06.01.2023, rrjedhimisht meqë ka pasur ankesë ndaj këtij procesi atëherë sipas Kolegjit, ankesa e parashtruar ka efekt pezullues sipas nenit 130 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, I cili përcakton se: *"Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, parashtrimi i një ankese pezullon, sipas fuqisë së ligjit, prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidh ankesën"*.

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.166/2023

Ilire-MEHMETI-SHAQIRI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Ferizajt;
- Kryetarit të Komunës së Ferizajt ;dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.